



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:213500
Datë: 24.01.2024
Numri i dokumentit: 05231295

AA.nr.167/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ramiz Kuqi kryetar, Delushe Halimi dhe Hajriz Hoti anëtarë, me bashkëpunëtorin profesionale Besarta Sopaj, në konfliktin administrativ sipas padisë së V... K..., nga Suhareka, kundër të paditurit Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit, duke vendosur sipas ankesës së paditësit, kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2194/2021, të datës 13.02.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit V... K..., nga Suhareka, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2194/2021, i datës 13.02.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2194/2021, të datës 13.02.2023, është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e datës 09.02.2023 e paditësit V... K... S..., për korrigjimin e pikës II të dispozitivit të Aktgjykimit A.nr.2194/2021, i nxjerrë nga Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar avokat Shkodran Manaj nga Fushë Kosova për shkak të: shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa dhe të anulohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2194/2021, i datës 13.02.2023 dhe lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë, në atë mënyre që të udhëzohet që të nxjerr aktvendim me të cilin aprovohet kërkesa e paditësit për korrigjimin e aktgjykimit A.nr.2194/2021, të datës 23.01.2023, krejt kjo me qëllim që paditësi të realizoj të drejtën e tij të njohur me aktgjykim ose të aprovohet si e bazuar ankesa dhe të

anulohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2194/2021, i datës 13.02.2023 dhe të vendoset që të aprovohet kërkesa e paditësit për korrigjimin e aktgjykimit A.nr.2194/2021, të datës 23.01.2023, krejt kjo me qellim që paditësi të realizoj të drejtën e tij të njohur me aktgjykimin A.nr.2194/2021, të datës 23.01.2023.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, ka gjetur se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, me datë 19.01.2023, ka marrë Aktgjykimin A.nr.2194/2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si e bazuar kërkesëpadinë e paditësit, dhe ka anuluar njoftimin e të paditurës nr.705/2021 të datës 30.08.2021 si dhe ka refuzua si te pa bazuar pjesën e kërkesëpadisë së paditësit V.. K..., me të cilën ka kërkuar të anulohet vendimi i Komunës së Prizrenit nr.01-111-115494 datë 09.08.2019, si dhe të vërtetohet fakti se paditësi është i punësuar pas të gjitha procedurave rekrutuese dhe të obligohet Komuna e Prizrenit-Drejtoria e Inspektorateve që në bazë të këtij aktgjykimi paditësit ti lëshoj akt emërimin lidhur me pozitën e përzgjedhur sipas njoftimit të datës 27.06.2019, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës së paditësit në afat prej 15 ditësh nga forma e prerë e aktgjykimit. Me datë 09.02.2023, paditësi V... K... ka propozuar korrigjimin e pikës II të dispozitivit të Aktgjykimit A.nr.2194/2021 me propozimin që të: *”II. Anulohet akti administrativ (njoftim) i të paditurës Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nr.705/2021 datë 30.08.2021 dhe detyrohet e paditura që në afat prej tridhet (30) ditësh të vendosë lidhur me ankesën e paditësit”*.

Gjykata, e shkallës së parë pasi analizoi kërkesën e paditësit të deponuar në gjykatë, si dhe pasi analizoi edhe shkresat e lëndës, ka konstatuar se nuk kemi të bëjmë fare me gabime në aktgjykim, si në pretendimin për *detyrimin e të paditurës që të vendosë lidhur me ankesën e këtij paditësit në afat prej 30 ditësh*, për faktin se paditësi *ka kërkuar të anulohet njoftimi i të paditurës KPMSHC Nr.705/2021 i datës 30.08.2021, si dhe të anulohet vendimi i Komunës së Prizrenit nr.01-111-115494 datë 09.08.2019, si dhe të vërtetohet fakti se paditësi është i punësuar pas të gjitha procedurave rekrutuese dhe të obligohet Komuna e Prizrenit-Drejtoria e Inspektorateve që në bazë të këtij aktgjykimi paditësit ti lëshoj akt emërimin lidhur me pozitën e përzgjedhur sipas njoftimit të datës 27.06.2019, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës së paditësit në afat prej 15 ditësh nga forma e prerë e aktgjykimit*, andaj Gjykata ka anuluar njoftimin e datës 30.08.2021 nr.705/2021 mbi bazën e nenit 47 dhe 48 të LPPA dhe ka refuzuar kërkesëpadinë si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, andaj me aktgjykim nuk është kthyer çështja në rishqyrtim dhe rivendosje te e paditura, apo të detyrohet e njëjta që me vendim të vendosë lidhur me ankesën, por se Gjykata e shkallës së parë vet ka trajtuar çështjen/objektin e kërkesëpadisë në konfliktin administrativ ashtu siç është vendosur në pikën III të dispozitivit, në këtë kuptim Gjykata e shkallës së parë konstatoi se nuk kemi të bëjmë fare me gabime në aktgjykim, ose gabime të tjera në shkrim, apo mungesa në aspektin e formës së aktgjykimit, shkaqe këto për të cilat lejohet korrigjimi i Aktgjykimit, në përputhje me nenin 165, par. 1 të LPK. Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative A.nr.2194/2021 datë 19.01.2023, nuk përmban gabime në kuptim të dispozitave ligjore të lartpërmendura. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë nuk ka gjetur gabimet e referuara në propozim dhe në rastin konkret nuk plotësohen kushtet ligjore për korrigjimin e aktgjykimit në kuptim të nenit 165 të LPK-së.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje të dispozitave procedurale të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë pasi ka analizuar kërkesën e paditësit të deponuar në gjykatë, si dhe pasi ka analizuar edhe shkresat e lëndës, me të drejtë ka konstatuar se nuk kemi të bëjmë fare me gabime në aktgjykim, andaj me të drejtë ka e ka refuzuar kërkesën e paditësit si të pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkelje të dispozitave procedurale, ky pretendim nuk qëndron meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurit në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se me të pranuar aktgjykimin A.nr.2194/2021 të datës 19.01.2023 tek ankuesi janë paraqitur dilema dhe paqartësi lidhur me çështjen, për shkak se me aktgjykim është aprovuar pjesërisht kërkesëpadija e paditësit dhe është anuluar akti administrativ (njoftimi) i të paditurës A. nr.705/2021 i datës 30.08.2021 andaj ankuesi ka parashtruar kërkesë për korrigjim të aktgjykimit. Gjykata e shkallës së parë duke mos ia falur besimin provave të administruara në mënyre të padrejte e ka injoruar kërkesën e arsyeshme dhe të logjikshme të paditësit lidhur me korrigjimin e aktgjykimit, duke vërtetuar gjendje faktike krejt tjetër nga ajo e cila është reale. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, ngase konsideron se të njëjtat janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të kërkesës të paditësit për korrigjim të aktgjykimit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara. Sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, si dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës. Ngase paditësi me asnjë provë nuk ka argumentuar vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, ndërsa provat e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike kjo gjykatë vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore se aktvendimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i përfshire me shkelje thelbësore të dispozitave të procedues kontestimore nga neni 182 par.2 pika n) të LPK-së, lidhur me nenin 63 të LKA dhe dispozitave tjera të LPK-së dhe LKA-së. Këto pretendime ankimore ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme për tu aprovuar ankesa, për faktin se gjykata e shkallës së parë ka anuluar njoftimin e datës 30.08.2021 nr.705/2021 mbi bazën e nenit 47 dhe 48 të LPPA dhe ka refuzuar kërkesëpadinë si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, andaj me aktgjykim nuk është kthyer çështja në rishqyrtim dhe rivendosje te e paditura, apo të detyrohet e njëjta që me vendim të vendosë lidhur me ankesën, por se Gjykata e shkallës së parë vet ka trajtuar çështjen/objektin e kërkesëpadiisë në konfliktin administrativ ashtu siç është vendosur në pikën III të dispozitivit, në këtë kuptim nuk kemi të bëjmë fare me gabime në aktgjykim, ose gabime të tjera në shkrim, apo mungesa në aspektin e formës së aktgjykimit, shkaqe këto për të cilat lejohet korrigjimi i Aktgjykimit, në përputhje me nenin 165, par. 1 të LPK. Duke u bazuar në këto prova dhe në dispozitat e lartcekura, kolegji vlerësoi se aktvendimi i ankimuar është i drejtë dhe i bazuar në gjendjen e vërtetuar

faktike e juridike. Kolegji i kësaj gjykate vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore të paditësit por të njëjtat i vlerësoi si të pa bazuara.

Prandaj, sipas vlerësimit të kësaj gjykate aktvendimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është në pajtim me dispozitat ligjore të lartcekura, dhe si i tillë aktvendimi është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të kërkesës së paditësit kërkesës të paditësit për korrigjim të aktgjykimit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore një aktvendim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktvendimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë, e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 209 par.1 nën b) të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.167/2023, me datë 05.01.2024

Kryetari i kolegjit,
Ramiz Kuqi